



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.63/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Lirim Ramabaja, kundër vendimit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.09.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet si i parregullt** apeli Anr.63/2019. i datës 20.09.2019, parashtruar nga Lirim Ramabaja me të cilin ka kërkuar që të përfshihet në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

## A r s y e t i m

Me datë 20.09.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Lirim Ramabaja, në të cilin parashtruesi i apelit pretendon se megjithëse i është pranuar kërkesa për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës, emri i tij nuk figuron në listën e përfundimtare të votuesve, andaj kërkon nga PZAP-i që të rishikojë listën.

Parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi të pretendimeve në apel.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj rregullsinë e apelimt, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i parregullt**

Paneli i PZAP-it, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga ana e Lirim Ramabajës është i parregullt, dhe si i tillë apeli nuk i plotëson standardet e kërkuara sipas nenit 10 par.7 dhe nenit 5 par.7 të Rregullës Nr.02/2015.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara ligjore nga dispozita e cekur më lartë.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit 5.7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.02/2015) dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr. 63/2019 më datën 20.09.2019

**Kryesues i Panelit**  
**Fejzullah Rexhepi**



***Këshillë Juridike:***

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*